



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija
Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade and Innovation

Kabineti i Ministres - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

Ref. Nr. 01/109

Datë: 20.07.2026

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit në mbështetje të nenit 11, paragrafit 1 nën paragrafi 1.5, nenit 30 dhe 31 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe 11, të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019) nenit 27 të Ligjit Nr. 05/L-117 për Akreditim, nenit 9 paragrafi 2 i Rregullores (QRK), Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 20 i Rregullores (QRK) - Nr. 04/2026 Për fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ (MINTI) Nr. 03/2026 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MTI) nr. 04/2019 Për Caktimin e Formës, Përbajtjes dhe Përdorimit të Logos të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës dhe Simbolit të Akreditimit dhe Referimi i Teksit në Akreditim.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës, si dhe organet tjera përgjegjëse që ta zbatoi Udhëzimin Administrativ nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Mimoza Kusari Lila

Ministre në detyrë

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministres;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit.*